



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës  
Press Council of Kosovo  
Savet Štampe Kosova

**10.01.2018, Prishtinë,  
Ref:24.10.2017\580-2017**

**Opinion i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj  
ankesës së Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, në mbledhjen e bordit të mbajtur më 19 dhjetor 2017, shqyrtoi ankesën e Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot lidhur me artikullin "Grupi Ahmedi & Sejdiu më i zi se klani 'Pronto'", botuar më 12 tetor 2017, dhe nxori këtë

O P I N I O N

- Ankesa miratohet

## A R S Y E T I M I

Në ankesë thuhet se gazeta Kosova Sot e ka quajtur kompaninë Devolli bandë famëkeqe serbo-çetnike", dhe "bandë hajdute dhe raciste". Në artikull thuhet se Devollët përveç politikës, kanë edhe mediat e tyre, të cilat propagandojnë dhe bëjnë jehonë për politikanët servil, të dëgjuarit e tyre, si dhe Vetëvendosja akoma është duke u shpërblyer nga "banda serbiane devolli".

KMShK, pasi e shqyrtoi ankesën dhe artikullin e lartëpërmendur vendosi se gazeta ka bërë shkelje të Kreut II (Raportimi i së vërtetës), pasi që ka botuar vetëm prononcimet e një grupi të analistëve të saj, pa i mundësuar edhe kompanisë Devolli që të prononcohet ose ndonjë organi kompetent apo ndonjë burimi të pavarur në mënyrë që të krijohej një pasqyrë më e qartë rreth temave që i ka shqyrtuar në artikull. Në këtë mënyrë edhe lexuesi do të përfitonte duke pasur parasysh se do të krijohej një spektër i gjerë i pikëpamjeve dhe fakteve në të mirë të së vërtetës.

Gjithashtu, KMShK konstatoi se gazeta nuk ka botuar asnjë prononcim të palës tjetër për çka ka qenë e obliguar sipas Kodit të Mediave të Shkruara, me çka do të përmbushej obligimi që del nga Kreu IV (E drejta për t'u përgjigjur) i Kodit të Mediave të Shkruara.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij opiniononi.

**Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës**